

Formular për SYLLABUS të kursit METODOLOGJIA E HULUMTIMEVE

Të dhëna bazike të kursit	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i kursit:	Metodologjia e hulumtimeve
Niveli:	MASTER
Statusi kursit:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti 1, semestri 1
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Caktohet nga dekanati në fillim të vitit
Mësimdhënësi i kursit:	Prof.asc. Avdullah Hoti
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kabineti 75 Email: Avdullah.Hoti@gmail.com Konsultimet: e enjte, ora 11:15-13:15

<p>Përshkrimi i kursit</p>	<p>Ky kurs përfshin ligjërata dhe ushtrime lidhur me aplikimin e metodave kuantitative dhe kualitative në hulumtime shkencore. Përmes këtij kursi studentët njihen me bazat konceptuale të hulumtimit (konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet), metodologjinë dhe strategjinë hulumtuese, llojet e të dhënave dhe analizën e tyre, mostrimin, anketimin dhe dizajnimin e instrumenteve hulumtuese (pyetësor të strukturuar, gjysmë të strukturuar, etj.), parashtrimin e hipotezave dhe formulimin e problemit shkencor dhe zgjedhjen e metodës adekuate hulumtuese dhe testimin e hipotezave. Po ashtu, në këtë kurs studentët njihen me treguesit kryesor statistikor dhe aplikimin e tyre në kuadër të punimeve shkencore.</p> <p>Duke pasur parasysh se hulumtimi dhe analizat kanë vlerë vetëm nëse shtjellohen e paraqiten në formë të qartë e mirë të strukturuar, studentët do të njihen me metodologjinë dhe rregullat e të shkruarit akademik, si dhe me elementet kryesore dhe rregullat për temën e masterit.</p>
<p>Qëllimet e kursit:</p>	<p>Qëllimi i këtij kursi është të pajis studentët me njohuri e shkathtësi për hulumtime shkencore. Në veçanti, kursi ka për qëllim të përgatis studentët lidhur me aplikimin e metodave kuantitative dhe kualitative në hulumtime, si dhe të ofrojë njohuri mbi shkrimin akademik, çështjet që lidhen me plagjiarizmin, pastaj njohuri dhe shembuj lidhur me standardet dhe struktura e punimit shkencor etj.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) aplikoj metodat kuantitative dhe kualitative në punën shkencore, (ii) përpiloj pyetësorë për hulumtime, të zhvilloj mostrën dhe aplikoi teknikat e hulumtimeve, (iii) analizoi të dhënat duke përdorur treguesit statistikor. (iv) konceptoj, organizoj dhe zhvilloj një punim shkencor duke aplikuar parimet dhe rregullat e shkrimit akademik.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë në javë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	12	24
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	2	6
Detyra të shtëpisë		12	12
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose shtëpi)	2	12	24
Përgatitja përfundimtare për provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	3	9
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali	12		102

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të organizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve, duke aplikuar diskutim interaktiv, grupe punuese, seminare, prezentime dhe ushtrime.
Metodat e vlerësimit:	<p>Për të marrë vlerësim pozitiv, studenti duhet të demonstroj se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Është i familjarizuar me specifikat e metodologjisë standarde të kërkimeve shkencore. (ii) Mund të aplikoj këtë metodologji në hulumtime shkencore dhe në punimin master. (iii) Mund të aplikojnë rregullat e shkrimit akademik në punime shkencore. <p>Provimi është individual dhe konsiston në një punim që studentët e punojnë në klasë, duke u koncentruar në këto çështje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Arsyeshmërinë e hulumtimit: qëllimi dhe propozimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ky hulumtim. 2. Metodologjinë hulumtuese: përshkruani shkurtimisht metodologjinë që do të përdorni në këtë hulumtim duke u koncentruar në metodat hulumtuese dhe arsyetimin për zgjedhjen metodës së caktuar. 3. Të dhënat: përshkruani mostrën, madhësinë e saj dhe treguesit statistikor që do të nxirrni nga të dhënat e grumbulluara. Duhet të sqaroni se cilët janë treguesit statistikor që ju do të llogaritni nga të dhënat e grumbulluara edhe ato kualitative.

Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Research methods for Business Students, Saunder, M., Lewis, P. And Thornill, A., Pearson Education Limited, Essex, 2007 2. Presenting Numbers, Tables, and Charts, Bigwood, S. and Spore, M., Oxford University Press, 2003 3. Si të Shkruajmë: Procesi dhe Shkrimet Funktionale, Boce, E. Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë 2004 4. Si të Shkruajmë Ese, Boce, E., Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2004 5. Si të Shkruajmë Një Punim Kërkimor, Boce, E, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2004
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Statistics for Business and Economics, Kohler, H., Thomson Learning, 2002 2. Si të Shkruhet Vepra Shkencore, Shamiq, M., Logosa, Focus Shkup, 2006 3. Essentials of Research Design and Methodology, Marczyk, G., DeMatteo, D. and Festinger, D., John Wiley & Sons, Inc., 2002 4. Quantitative Methods for Business, Management and Finance, Swift, L. and Piff, S., Palgrave Macmillan, New York, 2005 How to Write Great Essays, Tarkey, L., Learning Express, LLC, New York, 2004

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në metodologjinë hulumtuese: Konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet
Java e dytë:	Definimi dhe testimi i hipotezave hulumtuese
Java e tretë:	Sigurimi dhe grumbullimi i të dhënave: përcaktimi i madhësisë së mostrës, përzgjedhja e mostrës, dizajnimi i pyetësorëve
Java e katërt:	Anketimi: metodologjia, databaza dhe inspektimi i të dhënave, gabimet gjatë grumbullimit të të dhënave
Java e pestë:	Analiza e të dhënave: mesatarja, mesorja, moda, vlerat extreme (outliers), mospërgjigjet në pyetje, koeficienti i korrelacionit
Java e gjashtë:	Diskutime/seminare
Java e shtatë:	Përgatitja e raporteve me të dhëna statistikore
Java e tetë:	Metodat kualitative: përcaktimi i rasteve për hulumtim, përgatitja e pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupe, studimet e rastit, raportimi i të dhënave nga analizat kualitative
Java e nëntë:	Disa metoda kuantitative: OLS, Probit/Logit, Ordered Probit, Interval Regression
Java e dhjetë:	Shkrimi akademik: struktura, organizimi i punimit, paragrafet, argumentet, vështrimi kritik, përfundimi, plagjarizmi në punime shkencore
Java e njëmbëdhjetë:	Përgatitja e punimit shkencor dhe temës master
Java e dymbëdhjetë:	Diskutime/seminare
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
--	